

Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Terezë"
The Kosovo Humanitarian and Charity Society "Mother Teresa"
Kosovo Humanitarian and Charity Society "Mother Teresa"
16000 Prishtinë, Rt. Adem Jashari 30, Tel: 061 54 54 54, Fax: 54 54 54
Web site: www.shhbtk.org e-mail: shhbtk@shhbtk.org

KOMUNA E GJAKOVËS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me dt. 22.10.2018, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. Shoqatës Humanitare Bamirëse të Kosovës "Nëna Terezë", të cilën e përfaqëson Drejtori i Shoqatës Zef Shala në tekstin vijues SHHBK "Nëna Terezë".

Neni 1 Qëllimi

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët për të siguruar mjete financiare për familjen e Pjeter Karaqi, nga fshati Doblibare, Komuna e Gjakovës e cila është në kushte shumë të rënda ekonomike dhe sociale.

Neni 2 Përshkrimi i organizatës

2.1 Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nënë Tereza" është themeluar më 10 maj 1990 si organizatë joqeveritare (OJQ) dhe si e tillë ishte e para e këtij lloji në Kosovë. Gjatë viteve 90-ta kjo shoqatë humanitare ishte edhe frymë e solidaritetit tradicional, e sidomos në kohën kur popullit i'u ngritën virtytet për mbijetesë dhe mos nënshtrim ndaj regjimit të asaj kohe. Ajo ka punuar për të zhdukur varfërinë në Kosovë përmes sigurimit të ndihmave dhe mjeteve financiare për ndryshime të qëndrueshme për njerëzit e varfër dhe shtresën më të cenuar të shoqërisë nga uria, dhuna dhe sëmundjet.

Neni 3

Obligimet e Komunës

3.1. Komuna e Gjakovës do të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej 2000€ për përkrahjen e iniciativës së SHHBK “Nëna Terezë” për sigurimin e mjeteve financiare për familjen e Pjeter Karaqi. Mjetet do të sigurohen nga Subvencionet e Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3.2 Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që pas pranimi të të gjitha dokumentacionit që pasqyrojnë shpenzimet e bëra nga organizata SHHBK “Nëna Terezë” dhe pas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë financiare të Zyrës së Kryetarit të Komunës të fillojë procedurat e ekzekutimit të pagesës.

Neni 4

Obligimet e SHHBK “Nëna Terezë”

4.1 SHHBK “Nëna Terezë” obligohet të kryej të gjitha punët lidhur me përgatitjen teknike dhe administrative të projektit (verifikimin e dokumentacionit të pronësisë, shpalljen e tenderit për furnizim me material ndërtimor, zgjedhjen e fituesit të tenderit dhe lidhjen e marrëveshjes në mes të fituesit të tenderit dhe Shoqatës)

4.2 SHHBK “Nëna Terezë” obligohet që të përcjell ndërtimin nëpër faza si dhe të kujdeset për mirëvajtjen e projektit.

4.3 SHHBK “Nëna Terezë” obligohet që në kohë të duhur të njoftoj fituesin e tenderit, lidhur me planin e shpërndarjes së materialit sipas dinamikës së punëve në teren.

4.4 SHHBK “Nëna Terezë” obligohet që për çdo material apo mjete financiare të dërguara tek përfituesit t’ i dëshmoj donatorit me shkresë (Fletë përcjellëse të materialit, Fatura etj.) të nënshkruara nga përfituesit e projektit si pranues të mallit.

4.5 SHHBK “Nëna Terezë” obligohet që projektin t’ a përfundoj dhe raportoj më së largu deri me 25 Dhjetor 2018.

4.6 SHHBK “Nëna Terezë” obligohet që të siguroj raport të plotë financiar dhe narrativ lidhur me zhvillimin e aktiviteteve, shfrytëzimin e mjeteve etj. dhe atë më së largu 30 ditë pas përfundimit të projektit.

Neni 5
Realizimi i projektit

Realizimi i këtij projekti të organizuar nga SHHBK "Nëna Tereze", duhet të përfundoj dhe raportohet për punën e bërë më së largu deri me 25 Dhjetor 2018.

Neni 6

Ky memorandum i bashkëpunimit është përpiluar në 3 ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga 2 ekzemplarë i marrin palët kontraktuese, 1 ekzemplar Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.


PALËT

Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini



SHHBK "Nëna Tereze"


Zef Shala

